

## NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Nesrin Lushta, kryetare e kolegjit, Agim Maliqi dhe Emine Mustafa, anëtare, me bashkëpunëtoren profesionale Mirlinda Mejzini Simnica, procesmbajtës, në çështjen penale kundër të dënuarit Nj.I, për shkak të veprave penale vrasja në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së dhe mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK-së dhe veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPK-së, si dhe R.I, për veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 153 par.1 nënpar.1.4 të KPK-së, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë e paraqitur nga mbrojtësi i të dënuarit Nj.I, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.147/13 të datës 13.04.2018 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.276/2018 të datës 10.08.2018, në seancën e kolegjit, të mbajtur më 19 nëntor 2018, mori këtë:

## A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit Nj.I, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.147/13 të datës 13.04.2018 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës PAKR.nr.276/2018 të datës 10.08.2018.

## A r s y e t i m

### **Vendimi i Gjykatës Themelore**

Gjykata Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.147/13 të datës 13.04.2018, të dënuarin Nj.I, e ka shpallur fajtor për veprat penale vrasja në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së dhe mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK-së dhe veprës

penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPK-së dhe e ka gjykuar me dënim unik burgimi në kohëzgjatje prej 9 (nëntë) muaj dhe dënim burgimi në shumë prej 1000 (njëmijë) €, në të cilin dënim është llogaritur koha e kaluar në paraburgim prej datës 22.07.2012 deri me datë 03.08.2012. Nga i dënuari është konfiskuar revolva e tipit “B...” e kal.7.65 mre nr.serik A... me një karikator dhe dy copë fishekë. Në emër të paushallit gjyqësor është obliguar që ta paguaj shumën prej 60 €, kurse të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike janë udhëzuar në kontest civil.

Me të njëjtin aktgjykim kundër të pandehurit R.I, është refuzuar akuza për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale.

### **Vendimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës**

Gjykata e Apelit e Kosovës, me aktgjykimin PAKR.nr.276/2018 të datës 10.08.2018, ka aprovuar si të bazuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjilan për të dënuarin Nj.I, përkitazi me vendimin për dënimin dhe ka ndryshuar aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë për veprat penale vrasja në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së dhe mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK-së dhe i ka shqiptuar për veprën penale vrasja në tentativë nga neni 146 lidhur me nenin 20 të KPK-së dënim burgimi në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, kurse dënimin me gjobë prej 500 (pesëqind) €, për veprën penale mbajtja në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.1 të KPK-së e ka marrë si të vërtetuar, kurse ankesën e mbrojtësit të të dënuarit Nj.I e ka refuzuar si të pabazuar. Me të njëjtin aktgjykim ka aprovuar si të bazuar ankesën e mbrojtësit të të dënuarit Nj.I, përkitazi me veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 153 par.2 lidhur me par.1 nënpar.1.4 të KPK-së dhe e ka refuzuar akuzën. Kurse aktgjykimi i pjesës refuzuese përkitazi me R.I ka mbetur i paprekur.

### **Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë**

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë, ka paraqitur mbrojtësi i të dënuarit, av. A.S. nga Gjilani, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, shkeljes së ligjit penal dhe shkeljeve tjera të dispozitave të procedurës penale të cilat shkelje kanë ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor, me propozim që Gjykata Supreme e

Kosovës, ta aprovoj si të bazuar kërkesën dhe aktgjykimet e kundërshtuara të i ndryshoj ose ti anuloj dhe çështjen ta kthej në gjykatën e shkallës së parë në rivendosje.

### **Mendimi i Prokurorit të Shtetit**

Prokurori i Shtetit i Kosovës në Prishtinë, me parashtrësën KMLP.II.nr.190/2018, të datës 19.10.2018, ka propozuar, që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit, të refuzohet si e pabazuar.

### **Pretendimet e paraqitura në kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë**

Në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, theksohet se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së shkallës së dytë, janë marrë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1, nënëpar.1.12 të KPPK-së, meqë në aktgjykimet e kundërshtuara nuk janë paraqitur arsye se në bazë të cilave prova është bazuar aktgjykimi me të cilin i dënuari është shpallur fajtor dhe është dënuar. Gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e saj nuk ka bërë një analizë se në bazë të cilave prova ka ardhur në përfundim se i dënuari me dashje ka kryer veprën penale të tentim vrasjes. Arsyetimi bazohet vetëm në dëshmitë e dëshmitarëve –të dëmtuarve V.S. dhe B.L. edhe pse këto dëshmi janë kontradiktore dhe nuk i merr në konsiderim dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë M.N., D.I., Xh.S. dhe H.N. Për më tepër, theksohet se këto dëshmi janë pro deklarimit se i dënuari e ka kryer këtë veprë penale edhe pse dëshmitë e tyre nuk shkojnë në favor të faktit se i dënuari me dashje ka shkrepe me predhë me qëllim që ta godas të dëmtuarin V.S. Se gjuajtja me armë nuk ishte me dashje për vrasjen e të dëmtuarit por se gjuajtja ishte aksidentale, e pohon dëshmitarja e dëgjuar H.H. e cila dëshmi nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë e as nga gjykata e shkallës së dytë, mirëpo i kanë besuar vetëm dëshmisë së të dëmtuarit V.S., përkitazi me faktin se shkrepeja me armë ishte me dashje, ashtu që mos vlerësimi i drejtë i dëshmimeve të dëshmitarëve ka ndikuar në ligjshmërinë e vendimit gjyqësor.

Pretendohet se me aktgjykimet në fjalë është shkelur edhe ligji penal, duke u bazuar në teorinë dhe praktikën gjyqësore se për të ekzistuar vepra penale e vrasjes në tentativë i dënuari duhet të ndërmerr veprim aktiv me dashje për të privuar nga jeta të dëmtuarin, mirëpo rrethanat e caktuara jashtë dashjes së kryerësit e pamundësojnë kryerjen e veprës penale. Në këtë aspekt i

dënuari nuk kishte kurrfarë pengese të realizonte privimin nga jeta të të dëmtuarve V.S. dhe B.L. meqë armën e kishte në gjendje funksionale, municioni nuk i mungonte, e kishte forcën fizike, tereni hapësinor dhe largësia ishin të përshtatshme për ti privuar nga jeta të dëmtuarit pasi që nuk kishin se ku të fshiheshin, e të cilat rrethana të theksuara demantojnë kualifikimin ligjor siç pretendohet në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë dhe po ashtu edhe të shkallës së dytë, andaj duke u bazuar në theksimet e mësipërme qëndron shkelja e ligjit penal.

### **Gjetjet e Gjykatës Supreme të Kosovës**

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e mbajtur shqyrtoi të gjitha shkresat e çështjes dhe në kuptim të nenit 435 par.1 lidhur me nenin 436 par.1 të KPPK-së dhe pasi vlerësoi pretendimet në kërkesë konstatoi se:

kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk është e bazuar.

Nuk janë të bazuara pretendimet e paraqitura në kërkesë, se aktgjykimi i shkallës së parë dhe aktgjykimi i shkallës së dytë, janë marrë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sipas dispozitës së nenit 384 par.1 nënpar.1.12 lidhur me nenin 370 par.7 të KPPK-së. Në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë janë paraqitur fakte të plota dhe të qarta dhe në mënyrë të detajuar janë arsyetuar të gjeturat e gjykatës. Aktgjykimet e kundërshtuara nuk përmbajnë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, meqë të gjitha faktet janë vërtetuar në mënyrë të plotë dhe për secilin fakt janë paraqitur të dhëna të arsyetuara në secilën pikë të aktgjykimit dhe është dhënë arsyetim lidhur me faktet e vërtetuara dhe të pavërtetuara. Në arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, vlerësohet secila provë e administruar e sidomos faktet kundërrhënëse të cilat i paraqet e me këtë edhe dëshmitë e dëshmitarëve të dëgjuar M.N., D.I., Xh.S. dhe H.N. e po ashtu të të dëmtuarve V.S. dhe B.L. Arsyetimi është dhënë për vlerësimin e këtyre dëshmimeve dhe provave materiale e po ashtu edhe përkitazi me faktin se gjykata nuk i ka besuar versionit të paraqitur nga i dënuari. Për këtë është dhënë arsyetim në faqen e nëntë të aktgjykimit, ashtu që në mënyrë të drejtë gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e saj ka vërtetuar se në veprimet e të dënuarit janë formësuar të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprave penale për të cilën të dënuarin e ka shpallur fajtor dhe e ka dënuar.

Nuk qëndrojnë pretendimet e paraqitura në kërkesë se dëshmitë janë vlerësuar në mënyrë selektive dhe se gjykata e shkallës së parë u ka besuar vetëm dëshmitë të të dëmtuarve V.S. dhe B.L. Edhe pse është e saktë se këto dëshmi janë thelbësore megjithatë dhe se kanë qenë konsistente në të gjitha fazat e procedurës penale e për më tepër këto dëshmi janë të plotësuar edhe me dëshmitë e dëshmitarëve të tjerë dhe me ekspertizat mjeko ligjore përkitazi me natyrën dhe llojin e lëndimeve të marra nga të dëmtuarit, ashtu që konstatimet e theksuara në faqen e nëntë të arsyetimit të aktgjyqimit të gjykatës së shkallës së parë i pranon në tërësi edhe Gjykata Supreme e Kosovës.

Pretendimi i paraqitur në kërkesë, se i dënuari bazuar në rrethanat e përshkruara, po ta dëshironte pasojën ka mundur ta përfundoj veprën penale, është po ashtu pretendim i pabazuar. Bazuar në aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë është dhënë arsyetim i qartë përkitazi me këtë pasi që duke u bazuar në rrjedhën e ngjarjes e sidomos faktin se të dëmtuarit ishin gjendur para një shtate të papërshtatshme megjithatë veprimet e të dënuarit me të drejtë janë vlerësuar si veprime me qëllim të privimit nga jeta të të dëmtuarve. Fillimisht, duke u bazuar në faktin se të dëmtuarit nuk rezistuan fare dhe se shkrepja e armës nga një distancë prej 1,5-2 m. për më tepër në pjesën e epërme të trupit të të dëmtuarit e vërtetojnë në tërësi qëllimin mendor të të dënuarit për ta privuar nga jeta të dëmtuarin V.S., mirëpo ky veprim ka mbetur në tentativë ngase nuk ishte shkaktuar pasoja e dëshiruar nga i dënuari siç është përshkruar në arsyetimin e saj gjykata e shkallës së parë.

Edhe pse kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë, është paraqitur për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe shkeljes së ligjit penal, megjithatë bazuar në përmbajtjen e kërkesës, janë paraqitur pretendime për konstatimin e gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, mirëpo, këto pretendime nuk janë vlerësuar nga Gjykata Supreme e Kosovës, meqë bazuar në dispozitën e nenit 432 par.2 të KPPK-së, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk mund të ushtrohet për shkak të konstatimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Nga këto arsye, kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë ishte e pabazuar dhe konform nenit 437 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.275/2018, më 19 nëntor 2018

Bashkëpunëtorja profesionale,  
Mirlinda Mejzini Simnica

Kryetarja e kolegjit,  
Nesrin Lushta